

Investimi në kapitalin njerëzor: Thirrje për Veprim për Zhvillimin në Fëmijërinë e Hershme në Kosovë



Të mbledhur këtu sot më 22 shkurt 2022 si përfaqësues të institucioneve tona në nivelet më të larta të qeverisjes, nën patronatin e Presidentes së Republikës së Kosovës, ne e njohim rëndësinë e investimit në zhvillimin në fëmijërinë e hershme si bazë për ndërtimin e një kapitali të fortë njerëzor dhe si katalizator për zhvillimin dhe prosperitetin ekonomik të Kosovës.

Ne zotohemi të ndërmarrim veprime të koordinuara në pesë fusha që janë kritike për të arritur përmirësime për sa i përket rezultateve për fëmijët e vegjël dhe familjet e tyre.

- 1. VULLNETI POLITIK PËR ZHVILLIMIN NË FËMIJËRINË E HERSHME.** Ngritja e profilit të zhvillimit në fëmijërinë e hershme në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal dhe mbështetja e burimeve dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave që i japin përparësi agjendës së zhvillimit në fëmijërinë e hershme. Mbështetja dhe përkrahja e zhvillimit të fëmijërisë së hershme nga të gjitha palët dhe akterët është thelbësore për këtë objektiv afatgjatë.
- 2. INTEGRIMI I OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT NË FËMIJËRINË E HERSHME NË STRATEGJINË KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT** për të përfshirë ZhFH-në si prioritet në nivelin më të lartë. Hartimi i një Udhërrëfyese të integruar kombëtar me kosto përkatëse për zhvillimin në fëmijërinë e hershme, i cili bazohet në strategjitë sektoriale të Arsimit, Shëndetësisë, dhe Mbrojtjes Sociale, me një vizion të qartë, synime, objektiva dhe përgjegjësi për të gjithë akterët që e zbatojnë udhërrëfyesin, duke siguruar që të gjitha aspektet e cenueshmërisë për një fëmijë të mund të adresohen së bashku.
- 3. KRIJIMI I NJË KOMITETI TË LARTË DREJTUES PËR ZHVILLIMIN NË FËMIJËRINË SË HERSHME PËR TË BASHKËRENDUAR DHE PËRMIRËSUAR ZBATIMIN E POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ZHFH.** Fuqizimi i komitetit të lartë për drejtimin dhe monitorimin e progresit të zbatimit të Udhërrëfyesit Kombëtar të Zhvillimit të Fëmijërisë së Hershme kundrejt synimeve dhe treguesve të caktuar. Udhëheqja dhe përfaqësimi i fortë nga Ministritë kyçe, duke përfshirë Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve do të sigurojë bashkëpunim ndërsektorial dhe rezultate që tejkalojnë punën e sektorëve individualë.
- 4. RITJIA E FINANCIMIT PËR ZBATIMIN E POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE QË SYNOJNË VITET E HERSHME TË JETËS SË FËMIJËS.** Rritja e alokimit buxhetor në nivel qendror dhe lokal, në përputhje me standardet e cilësisë, në mbështetje të programeve dhe shërbimeve për fëmijët e moshës 0-6 vjeç në të gjithë sektorët. Eksplorimi i opsioneve alternative të financimit për ta përmirësuar cilësinë dhe barazinë e shërbimeve për ZhFH dhe për të zgjeruar disponueshmërinë e tyre veçanërisht për fëmijët më të cenuar.
- 5. OFRIMI I MBËSHTETJES PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE TË VEGJËL PËR T'I PËRMIRËSUAR REZULTATET E ZHVILLIMIT.** Rritja e kërkesës nga prindërit për shërbime të fëmijërisë së hershme për përmirësuar njohuritë rreth rëndësisë kritike që ka një mjedis mbështetës, i shëndetshëm dhe stimulues. Integrimi i mbështetjes së prindërve dhe programet e tjera në fëmijërinë e hershme në shërbimet ekzistuese për t'i mbështetur dhe fuqizuar prindërit për përkujdesjen e përgjegjshme.